

KONTRATË SHITJE

(Kuotash të Shoqërisë)

Në Tiranë, sot më datë 01.03. 2023, në zyrën e shoqërisë "Bigalb Group" sh.p.k, duke u bazuar në legjislacionin shqiptar, në veçanti në ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe shoqëritë Tregtare", i ndryshuar dhe të ligjit Nr.9723 date 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, lidhet kjo kontratë huaje midis palëve të mëposhtme:

PALA E PARË: Znj. Monika Çela, e bija e Metes, e datëlindjes 14.07.1965 e lindur në Vlorë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 032287801 dhe nr personal G55714058E, që këtu e në vijim. "Shitësi"

PALA E DYTË: Z. Artur Brahimaj, i biri i Qerimit, i datëlindjes 22.09.1965 i lindur në Selenicë dhe banues në Tiranë, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me nr. karte ID 036622977 dhe nr personal G50922123I, që këtu e në vijim "Blerësi"

HYRJE

A. Shoqëria "BIG VIZION" shpk, është person juridik i regjistruar në regjistrin tregtar pranë QKB më datë 28.10.2022, pajisur me nipt M22228024D, me seli në adresën *Rruga Egnatia, Njësia Administrative 11, Godina 8/1, Tiranë*, me ortakë:

- | | |
|---------------------------------------|---|
| 2.1.1 Shoqëria "BIGALB GROUP": | Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51%; |
| 2.2.1 Znj. Monika Çela: | Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 49% |

B. Palët kanë rënë dakort që një pjesë të kuotave të zotëruara nga Shitësi, të kalojnë tek Blerësi mbas firmosjes së kësaj kontrate dhe kalimit të pagesës.

C. Shoqëria "BIG VIZION" shpk, dhe ortaku, Shoqëria "BIGALB GROUP" shpk, me vendimin Nr. 3 të datës 01.03.2023, në mënyrë të shprehur kanë dhënë aprovimin e tyre për tjetërsimin e kuotave

Duke vlerësuar bashkëpunimin dhe interesin e ndërsjellë, palët bien dakort për redaktimin e kësaj Kontrate Shitje si më poshtë:

Neni 1

Baza Ligjore

- 1.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, më posaçërisht Nenet 659 e vijues të tij;
- 1.2 Ligji Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", më posaçërisht nenet 72-75 të tij.

Neni 2

Objekti

- 2.1 Shitësi do t'i shesë Blerësit, një pjesë të kuotave të saj, në masën në masën e 24% të kapitalit, nga totali prej 49% (dyzetë e nëntë për qind) që Shitësi zotëron në shoqërinë Big Vizion.

Faqe 1 nga 2

2.2 Mbas shitjes së kuotave, Shoqëria "BIG VIZION" shpk, do të zotërohet nga ortakët në si më poshtë:

1. Shoqëria "BIGALB GROUP": Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 51% (pesëdhjetë e një për qind);
2. Znj. Monika Çela: Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 25% (njëzet e pesë për qind);
3. Z. Artur Brahimaj Numri i Pjesëve 1 (një);
Pjesëmarrja në përqindje 24% (njëzet e katër për qind).

Neni 3

Afati

3.1 Afati i kalimit të këtyre kuotave do të jetë një 1 (një) mujore nga nënshkrimi i kësaj kontrate.

Neni 4

Vlera e shitjes

4.1 Kuotat do të shiten me vlerën nominale prej 1.440,000 (një milion e katër qind e dyzetë mijë) lekë.

Neni 5

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 5.1** Palët bien dakort që çdo mosmarrëveshje që mund të lindë në lidhje me kuptimin dhe realizimin e kësaj kontrate, do ta zgjidhin me mirëkuptim.
- 5.2** Në rast se mosmarrëveshjet e mundshme nuk zgjidhen me mirëkuptim, secila nga palët mund t'i drejtohet për shqyrtim Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- 5.3** Legjislacioni i zbatueshëm do të jetë legjislacioni shqiptar.

Neni 6

Të tjera

- 6.1** Kontrata lexohet nga ne palët dhe pasi gjendet konform ligjit dhe vullnetit tonë të lirë, e nënshkruajmë atë rregullisht.
- 6.2** Kontrata redaktohet në 2 kopje, me fuqi të njejtë.
- 6.3** Bashkangjitur dokumentat:
 1. Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar të Shoqërisë "BIG VIZION" shpk;
 2. Vendim Nr. 03. datë 01.03.2023 i Shoqërisë "BIG VIZION" shpk;
 3. Dokumentat ID të palëve

PALËT:

SHITËSI

Znj. Monika Çela



BLERËSI

Z. Artur Brahimaj

